

Në bazë të Nenit 35 të Ligjit mbi Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, rishpallë:

KONKURS

Për plotësimin e pozitës:

Drejtor i RTK 2 – TV

Drejtori i RTK 2 – TV:

- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV duhet të jetë person me përvojë të gjerë të menaxhimit të medieve apo fushave të tjera relevante;
- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV duhet të jetë shtetas i Kosovës dhe me vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Drejtori i Kanalit RTK 2 - TV përzgjidhet dhe emërohet nga Bordi i Drejtorëve, përmes konkursit publik duke marrë në konsiderim rekomandimin e Grupit Punues për Përzgjedhjen e Drejtorit të Kanalit Televiziv në gjuhën serbe.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Menaxhon veprimtarinë e Kanalit RTK 2 - TV në pajtim me Ligjin e RTK-së, Statutin e RTK-së, dhe Kodin Etik të RTK-së;
- Administron dhe menaxhon Kanalin RTK 2- TV, duke siguruar funksionim efektiv dhe efikas;
- Përgatit planin vjetor programor, i cili përmban vëllimin edhe strukturën e programit dhe është në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
- Përgatitë raportin vjetor mbi përmbushjen e planit programor për nivelin e shikueshmërisë së programit televiziv, posaçërisht për emisionet e reja;
- Planifikon, organizon dhe mbikëqyr procesin e punës në njësinë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Është përgjegjës për transmetimin e programit në tërësi si dhe për transmetimin e reklamave sipas kornizës ligjore;
- Mbikëqyrë përmbushjen e planit programor me numër minimal të ekzekutuesve;
- Mbikëqyrë arsimimin dhe zhvillimin e kuadrove të reja me perspektivë;
- Zhvillon bisedat e rregullta vjetore në njësitë programore;
- Udhëheqë dhe përfaqëson njësitë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Përgatitë normativat dhe standardet programore;
- Përgatitë strategjitë zhvillimore për njësitë programore të Kanalit RTK 2- TV;
- Siguron cilësinë e programit sipas strukturës së programit të përcaktuar me ligj;
- Përcjellë menaxhimin e mjeteve financiare për çdo emision, duke përllogaritur çmimin për një minutë të programit;
- Organizon përpilimin dhe nënshkruan të gjitha dokumentet mbi afarizmin financiar të njësisë programore të Kanalit RTK 2 – TV, përfshirë edhe pagesën e punës me honorar;
- Përgatitë emisionet e reja me shkallën paraprakisht të përcaktuar të shikueshmërisë;
- Vlerëson shikueshmërinë dhe statistikat programore;
- Mbikëqyrë arkivimin e materialit programor;
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm.

I punësuar për punën e vet në cilësinë e Drejtorit të Kanalit RTK 2 – TV i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

Kushtet që duhen plotësuar:

- Kualifikim superior profesional në drejtimin përkatës;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në menaxhimin e mediave apo fushave të tjera relevante (Përparësi kanë kandidatët me përvojë më të gjatë);
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral;
- Të ketë njohuri të shkëlqyeshme të spektrit medial në Kosovë, regjion dhe më gjerë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në organizim, udhëheqje dhe planifikim;
- Aftësi udhëheqëse dhe komunikuese;
- Standard të lartë të gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar;
- Njohje të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efektive nën presion;
- Të mos ketë dëshmuar përkatësi partiake;
- Njohuri e programeve MS Word, Excel dhe të tjera;
- Aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë;
- Përkushtim ndaj shërbimit publik të transmetimeve.

Në bazë të Ligjit për RTK-në, Drejtor i RTK 2 - TV nuk mund të emërohet personi, i cili:

- a) mban post publik të zgjedhur (funksionarët publik);
- b) ka qenë deputet, ministër, zyrtarë i lartë i pushtetit qendror apo lokal, apo anëtarë i forumeve drejtuese të subjekteve politike gjatë tri (3) viteve të fundit;
- c) ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose indirekt në biznesin e medieve dhe reklamave ose
- d) është dënuar pas procesit të rregullt, për veprë penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- një CV,
- një certifikatë të lindjes,
- një kopje të letërnjoftimit,
- një letër motivuese,
- tri referenca,
- dëshmitë e kualifikimit,
- dëshmi që nuk është nën hetime, të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit, si dhe
- aplikacionin, i cili duhet të shkarkohet nga web faqja e RTK-së, www.rtklive.com.

Bashkëngjitur me këtë dokumentacion, kandidati duhet të dorëzojë edhe një projekt lidhur me synimet zhvillimore të Kanalit RTK 2 - TV (deri në 3 faqe).

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes internet adresës konkurs@rtklive.com, deri më datë 30.09.2020 në orën 16:00.

Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.

Aplikacionet e dërguara me vonesë nuk do të pranohen.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.